

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"3FISH RESTAURANT" SHPK

Date 13/01/2025

KREU I

THEMELIMI, EMRI, FORMA LIGJORE, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA

Neni 1

THEMELIMI

Sot më date 13 Janar 2025, z.Ermir Hasani, l.datëlindjes 30/10/1996, lindur në Tiranë, Shqipëri, banues në Tiranë, me numër personal J61030060C, me zotësi të plotë juridike për të vepruar ka venodur të themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjin Nr.9901, datë 14 Prill 2008 "Për Shoqëritë Tregtare në Republikën e Shqipërisë" ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave të mëposhtëme.

Neni 2:


EMRI, FORMA LIGJORE

1. Emri i shoqërisë është **3FISH RESTAURANT Sh.P.K.** (më poshtë referuar si shoqëria).
2. Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
3. Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
4. Aktiviteti i shoqërisë do të ushtrohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave të paraqitur në këtë Statut dhe Akt Themelimi.

Neni 3:

SELIA

1. Shoqëria e ka selinë në: Rruga e Kavajës, Kryqezimi 21 Dhjetori, Nr. Pasurie 5/135-N4, Zk.8210, Vol.13, Fq.56, Tiranë, Shqipëri
2. Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.



Neni 4:
OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

1. Restorant dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm.
2. Çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të Shoqërisë e që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 3:
KOHËZGJATJA

1. Shoqëria themelohet dhe do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

KREU II
KAPITALI FILLESTAR THEMELTAR


Neni 6
KAPITALI THEMELTAR DHE ORTAKËT

1. Kapitali fillestar i shoqërisë është 500 lekë (pesëqind lekë). Pjesmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të rreposhtme:
— Ortaku themelues, Ermir Hasani, Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere të përgjithshme 500 lekë që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

KREU III
ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Neni 7
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHMË

1. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
3. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;



- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit/ëve;
- d) shkarkimin e emërimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tvre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;

Neni 8

MBLEDHJET E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHMË


1. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakeve, jo me vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Asambleja e përgjithshme mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të rimbrotur interesat e shoqërisë.
3. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm me miratimin e të gjithë ortakeve, nëse janë të pranishëm, pavaresisht parregjishtisë.

Neni 9

REGJISTRIMI I VENDIMEVE DHE KUORUMI

1. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit janë të pandryshueshme. Regjistri i Vendimeve duhet të mbahet nga Administratori dhe çdo regjistrim nënshkruhet prej tij.
2. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme me miratimin e ortakut të vetëm.

Neni 10



MANDATI DHE TË DREJTAT E PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

1. Shoqëria do të drejtohet nga administratori dhe ortaku i vetem, Ermir HASANI, Shtetas Shqiptar, lindur më 30/10/1996, Tiranë, Shqipëri, ne nr.ID J61030060C, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Administratori i shoqërisë emerohet për një periudhë kohore 5 vjetore me të drejte rizgjedhje.
2. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
 - kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - përgatisë dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecuresë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblese së përgjithshme për miratim;
 - krijojnë një sistem paralajmerimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhenat e detyrueshme të shoqërisë, sië parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
3. Administratori mund të autorizojë nëpërmjet një procedure një person të tretë për të përfaqësuar Shoqërinë.
4. Administratori është përgjegjës ndaj Shoqërisë për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e mospërbushjes së përgjegjësive të parashikuara në Statut dhe legjislacioni në fuqi.

KREU IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMIT

Neni 11


VITI FINANCIAR

1. Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.

Neni 12

SHPËRNDARJA E FITIMEVE

1. Pas miratimit të pasqyrave financiare vjetore, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me shpërndarjen ose jo të fitimit, nëse ka.



2. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
 - Aktivitet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

KREU V
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 13
PRISHJA DHE LIKUIDIMI

1. Në rast se Asambleja e Përgjithshme vendos për prishjen e Shoqërisë, do të emërojë një ose më shumë likuidues.
2. Prishja dhe likuidimi kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.


KREU VI
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 14
BAZA LIGJORE

1. Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë lidhur me aktivitetin e Shoqërisë.
3. Nëpërmjet këtij Statuti autorizohet Administratori i Shoqërisë, z.Ermir Hasani, për t'u paraqitur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe të depoztojë këtë Statut dhe Akt Themelimi në mënyre që të kryhet regjistrimi i Shoqërisë.

*****ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË*****

"3FISH RESTAURANT" SHPK


(emër, mbiemër, nënshkrim)